



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. \_\_\_\_\_/2019

Datë: 25.04.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 25 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.04.2019, pas diskutimit lidhur me pikën e 3-të, të rendit të ditës: Propozim vendim për këmbimin e pronës komunale, e miratoi këtë:

### V E N D I M

#### Për këmbimin e pronës komunale

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin për shpalljen e interesit publik, dhe këmbimin e pronës komunale me numër kadastral P-707050390-00380-1, me pronën e Agjencionit Pyjor me numër kadastral P-70705039-00021-1.
2. Parcela me numër P-707050390-00380-1 Z.K Gjakovë J, Qytet, me sipërfaqe totale prej 38090 m<sup>2</sup>, në pronësi të P.SH. Kuvendi i Komunës Gjakovë të këmbetet me pronën me numër P-70705039-00021-1 Z.K Gjakovë J Qytet në pronësi të Agjencionit Pyjor në sipërfaqe prej 391182 m<sup>2</sup>.
3. Këmbimi i pronave të lartcekura në pikën 1 dhe 2 të këtij Propozim Vendimi bëhet me qëllim që të ndërtohen 5 shtëpi për 5 familjet të Komuniteteve pakicë që jetojnë në fshatin Netic dhe nuk posedojnë prona të tyre.
4. Këmbimi do të bëhet sipas vlerës së caktuar nga Komisioni për Vlerësimin e Pronës dhe vlera do të llogaritet sipas çmimit të tregut.
5. Obligohen organet e administratës komunale që të zbatojnë procedurat ligjore për këmbimin e pronës komunale sipas pikës 1 dhe 2 të këtij propozim vendimi konform Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

#### 7. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës, z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Drejtori së për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivii

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
**Anton Shala**